


RAPORTI 3 MUJOR I
DREJTORISË PËR
ADMINISTRATË TË
PËRGJITHSHME

Janar- Mars – 2019



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Uprava za Opštu Administraciju / Directory of General Administration



Në kuadër të drejtorisë për administratë të përgjithshme funksionojnë në këtë sektorë:

1. **Sektori për Administratë të Përgjithshme**
2. **Sektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve**
3. **Sektori për Gjendjen Civile**
4. **Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të Objekteve**
5. **Sektori për barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe integritet evropiane dhe të drejtat e fëmijëve.**
6. **Sektori për teknologji informative**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odjeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot. 1385 Më 26.04.2013
Br. prot. Dt. 26.04.2013
RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti paraqet aktivitetet dhe të arriturat e përgjithshme për periudhën 01.01.2019 deri më 31.03.2019, më poshtë po i cekim në pikat të shkurtëra aktivitetet e zhvilluara .

Në bazë të planifikimit të punës për 3 mujin e parë , Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka kryer këto aktivitete si në vijim:

- Gjatë muajit janar janë bërë konsulta të ndryshme me punëtorët rreth planifikimit të punëve për tremujorin e parë, dhe kemi vazhduar punët sipas planit të punës për vitin 2019
- Në fillim të muajit Janar është mbajtur takimi i rregullt me punëtorët e Administratës së Komunës së Rahovecit, duke uruar kështu edhe punëtorët për fillimin e ri të vitit 2019
- Kontrollimi i të gjitha zyreve të gjendjes civile në terren
- Pjesëmarrja në takime të ndryshme, siç janë: Asambleja Komunale, takimet me bordin ekzekutiv
- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materiale të nevojshme, dërgimi ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (3 mbledhje) të Kuvendit Komunal
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa

- Nxjerrja e vendimeve, aktvendimeve, urdhëresave
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL sipas kërkesës së tyre
- Sistemimi i materialeve në dosjet e arkivit
- Janë realizuar përkthime të ndryshme sipas nevojës
- Kontrollimi i automjeteve dhe ndarja e tyre
- Sektori për gjendje civile në tre mujorin e parë të vitit 2019 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. SGJC ka bërë regjistrimet e ndryshme, përfshirë regjistrime të lindjeve, vdekjeve, martesave, etj.
- Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve brenda kompetencave ka kryer punët rutimore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbrim etj.).
- Zyra për Barazi gjinore, si pjesë e institucionit komunal merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut e në veçanti të grave, kështu për nder të ditës ndërkombtare të gruas në bashkëpunim me shoqatën e gruas "Hareja" ka organizuar një sërë aktivitetsesh, përfshirë këtu edhe një marsh paqësor.
- Sektori për teknologji informative është shumë dinamik, dhe ka rëndësi të madhe për shkak të vizionit dhe realizimit të qeverisjes elektronike, gjatë periudhës tremujore ka zhvilluar shumë aktivitete si: kontrollimi i serverëve, rrjetit, zyreve të gjendjes civile (zyret e vendit), përkrahja e punëtorëve sipas nevojës etj.
- Në fillim të muajit mars është shpallur tenderi për E-Kioskun
- Gjatë kësaj periudhe kanë filluar edhe procedurat për binjakëzimin e Komunës së Rahovecit me dy komuna të Italisë, komuna këto të ngjashme me profilin e Komunës sonë.
- Është bërë regjistrimi i të gjitha automjeteve zyrtare dhe servisimi i tyre.

Me Respekt!

Saranda Sallteku

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme